



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

### RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
<b>Flori Rexhepi</b>	<b>19.01.2024</b>	<b>01.02.2024</b>	<b>2024/0052</b>

#### BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 15.01.2024, OE “"TRIANGLE" SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0052, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "N.N.P. EURO CONSTRUCTION ", lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Renovimi i shkollave fillore -renovimi i rrjetit të ujesjellesit, kanalizimit në nyjat sanitare në IEAA” me nr. të prokurimit: "616-23-10869-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: pune, vlera e parashikuar e kontratës: 70,000.00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 09.10.2023; data e hapjes së ofertës: 30.10.2023; data e njoftimit mbi vendimin e AK-se: 15.12.2023; data e njoftimit me letër standarde: 15.12.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

#### DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:

Neni 1 Qëllimi,

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Neni 61 Tenderët Jo-normalisht të Ulët

Gjithashtu AK ka shkelur edhe dispozitat përkatëse të Rregulloreve të KRPP-se.

## KRITERET PËR VLERËSIM

		<p><b>Kërkesat e përshtatshmërisë:</b></p> <p>1.Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga <a href="http://krpp.rksgov.net">http://krpp.rksgov.net</a></p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , - Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit</p> <p>2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohej kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.</p> <p>3. Dëshmi se kompania nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore te lëshuar nga Gjykata - kërkohej origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.</p> <p>4. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik,</p>
--	--	---	--

			<p>ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe</p> <p>b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor. Për piken (a) dhe (b) Kërkohe origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontrate të sjellë dokumentet të kërkuara në piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues që ofertën ta refuzoj, të konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe të vazhdoj me shpërblim të kontratës me Operatorin Ekonomik që është listuar në vendin e dytë.</p>
--	--	--	---

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	<b>Përshtatshmëria profesionale:</b>  <b>1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit për ushtrimin e veprimtarisë-Numri Unik Identifikues</b>  <b>2.Certifikata e numrit fiskal</b>	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>  <b>1.Kopja e Certifikatës se biznesit-Numri Unik Identifikues</b>  <b>2.Kopja e Certifikatës se numrit fiskal</b>
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	<b>Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</b>  <b>N a</b>	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>  <b>N a</b>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	<b>Kapaciteti teknik dhe <u>professional</u>:</b>  <b>1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, ne vlere minimale prej 100.000.00 Euro, në 3 (tri ) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë).</b>  <b>2.OE duhet te ofroj kete staf si ne vijim a)Nje Inxhinier i diplomuar i ndertimtarise,drejtimi konstruktiv, Menaxher i projektit – min. 5 vite përvojë pune b) Nje inxhinier i ndertimit i diplomuar apo bachelor -drejtimi hidroteknik min. 5 vite përvojë pune. c) Dy (2) teknik të ndërtimtarisë me 3 vite përvojë pune, te jene te qertifikuar per siguri dhe shendet ne pune</b>	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i>  <b>1. Një listë te kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 te Dosjes se Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datë n e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te punëve</b>  <b>2. Per inxhinieret e kerkuar CV, diploma, Kontrata e punes me punedhenesin ose marrëveshja mbi angazhimin per kete project, si dhe Referenca per punet e meparshme ne lemin e kerkuar te leshuar nga punedhenesi, ndersa per 2 tekniket , diploma e shkolles se mesme profesionale , kontratat e punes me punedhenesin , ose marreveshje per angazhim ne kete projekt.</b>

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues është i papërgjegjshëm.

OE i rekomanduar për kontratë është i përgjegjshëm.

## INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

## VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **"TRIANGLE" SH.P.K.**

### **Sqarim hyrës**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, konform nenit 108/A ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontaktues –Komuna e Prishtinës, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se, kryesisht nenin 59 të LPP-se, me këtë rast ka rekomanduar për kontratë një operatore ekonomik i cili nuk i plotëson kriteret e dosjes se tenderit.

Autoriteti Kontaktues –Komuna e Prishtinës, me datën: 15.12.2023, ka publikuar njoftimin B46 - Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm.

OE ankues me datën: 26.12.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim ndërsa AK-ja me datën 04.01.2024 refuzon kërkesën e OE ankues si të pabazuar.

### **Pretendimi nr.1**

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues Triangle, i pakënaqur me vendimin e AK-se, ka parashtruar ankese me pretendimin se AK-ja nuk i ka zbatuar dispozitat e LPP-se, konkretisht me rastin e përfundimit të vlerësimit të ofertave autoriteti kontraktues e ka njoftuar me letrën standarde të tenderuesit të eliminuar dhe njëherit OE ankues pretendon se AK-ja, e ka rekomanduar për kontratë një operatore ekonomik të papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues e ka pranuar letrën standarde të eliminuar përmes të cilës është njoftuar si i papërgjegjshëm me arsyetimin se e ka tejkaluar vlerën e parashikuar të kontratës e cila ka qenë: 70,000.00€, ndërsa vlera e ofertës se OE ankues është: 104,444.00€.

Sa i përket arsyes se eliminimit të OE ankues, i cili lidhur me këtë çështje pretendon se është i paqëndrueshëm ky pretendim i autoritetit kontraktues sepse ky tender është kontratë kornizë dhe se sipas dispozitave të pikës 2 të nenit 38 të LPP-së, ne kontratat kornize mospërputhja totale e vlerës lejohet deri ne plus minus 30% të vlerës totale. Pra, sipas OE ankues eliminimi jone nga ky aktivitet i prokurimit, është i kundërligjshëm sepse AK-ja ka vepruar ne kundërshtim me nenin 38 të LPP-se.

Eksperti shqyrtues, sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues për shkelje të dispozitave ligjore të nenit 38 të LPP-së, për faktin se OE ankues bën interpretim të gabuar të dispozitave të nenit 38.2 të LPP-së, për faktin se fillimisht duhet të merret parasysh neni 54.10 i Rregullores për prokurim publik.

Megjithatë eksperti shqyrtues sqaron se oferta e OE ankues është 49% me lart se vlera e parashikuar e kontratës, që do të thotë se edhe po të aplikohet neni 38.2 i LPP-se ashtu si pretendon OE ankues, atëherë edhe ne këtë rast oferta financiare e OE ankues është me shume se 30% i vlerës se parashikuar të kontratës. Pra, OE ankues ne këtë rast i ka plotësuar kushtet për tu kualifikuar si palë pa interes material të parapare ne nenin 4.1.26 të LPP-se.

### **Pretendimi nr.2**

OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontratë nuk e ka plotësuar aneën 6 të dosjes se tenderit – listën e kontratave të realizuara.

Eksperti shqyrtues, sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues se i rekomanduari duhet te shpallet i papërgjegjshëm, sepse OE i rekomanduar për kontratë e ka dorëzuar listën e kontratave e cila është njëjtë me atë të dosjes se tenderit, pra i përmban të gjitha të dhëna e kërkuara nga autoriteti kontraktues.

### **Pretendimi nr.3**

OE ankues, ne ankesën e tij ka pretendime ankimore në lidhje me ofertën e të rekomanduarit për kontratë, për te cilin pretendon se e ka falsifikuar nënshkrimin e Inxhinierit të Hidroteknikes, ( **F. G**) me arsyetimin se ne disa dëshmi të inxhinierit ne fjalë nënshkrimi është i njëjtë ndërsa ne një dëshmi ndryshon.

Me qellim të verifikimit të pretendimit të OE ankues, me datën: 26.01.2024 ne cilësinë e ekspertit

shqyrtues i jam drejtuar me shkrim inxhinierit F.G, te cilin e kam njoftuar me dëshmitë për të cilat pretendohet se janë të falsifikuara

*Në përgjigje të kërkesës Inxhinierit F.G është përgjigjur me datën: 30.01.2024, i cili ka deklaruar se për projektin: Renovimi i Shkollave fillore - renovimi i rrjetit te ujesjellesit, kanalizimit ne nyjet sanitare ne IEAA me numër identifikues: 616-23-10869-5-2-1 deklaroj me përgjegjësi të plotë se jam në marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë NNP EURO CONSTRUCTION (Bislim Morina) B.I. Gjithashtu deklaroj se unë e kam nënshkruar kontratën për bashkëpunim lidhur me këtë projekt dhe i qëndroj prapa nënshkrimit tim.*

Eksperti shqyrtues, duke u bazuar ne sqarimin e Inxhinierit F.G, vlerëson se nuk qëndron pretendimi i OE ankues për falsifikim të dokumenteve për faktin se Inxhinieri e ka konfirmuar se për projektin ne fjale është në dijeni dhe se ka bashkëpunim me OE të rekomanduar për kontratë.

#### **Pretendimi nr.4**

OE ankues, pretendon se i rekomanduari për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën e DT-se, lidhur me përvojën e punës për Inxhinierit e Ndërtimtarisë. ( J. M), ku ne dosje te tenderit është kërkuar min. 5 vite përvojë pune dhe se sipas OE ankues Inxhinieri ne fjalë ka diplomuar me 11.02.2022.

Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë pretendim sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues, sepse inxhinieri ne fjalë ka ofruar dëshmi te mjaftueshme se ka diplomuar me datën: 02 Qershor 2008.

Fakti qe ne diplomën e re ne të cilën ka pasur qasje OE ankues, është shënuar data: 11.Shkurt 2022, është bere për arsye se ne diplomën e lëshuar me datën: 02.Qershor.2008 nuk i është shënuar drejtimi konstruktiv por është shënuar vetëm dega ndërtimtari dhe me qellim te korrigjimit te këtij lëshimi me kërkesë te vet inxhinierit është bere kërkesa pran universitetit dhe pas korrigjimit i është lëshuar diploma e re ne te cilën figuron data e lëshimit 11.02.2022, ndërsa data e diplomimit është 02.Qershor.2008. Prandaj, pretendimi i OE ankues është i paqëndrueshëm.

Diploma e pare:



<p>FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS</p> <h1 style="text-align: center;">DIPLOMË</h1> <p style="text-align: center;">E KUALIFIKIMIT UNIVERSITAR</p> <h2 style="text-align: center;">JASMIR NAZIM MORINA</h2> <p style="text-align: center;">LINDUR NË HODONOC-KAMENICË MË 29 GUSHT 1978</p> <p style="text-align: center;">REGJISTRUAR NË VITIN AKADEMIK 1997/98</p> <p style="text-align: center;">MË 30. 04. 2008 I KA DHËNË PROVIMET E PARAPARË</p> <p style="text-align: center;">PËR TË MBARUAR FAKULTETIN E</p> <p style="text-align: center;">NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS</p> <p style="text-align: center;"><b>DEGA NDËRTIMTARI</b></p> <p style="text-align: center;">DHE ME KËTË MERR KUALIFIKIMIN</p> <p style="text-align: center;"><b>INXHINIER I DIPLOMUAR I NDËRTIMTARISË</b></p> <p style="text-align: center;">Nota mesatare gjatë studimeve <b>6.74</b></p> <p style="text-align: center;">Nota e provimit të diplomës <b>9.00</b></p> <p style="text-align: center;">PRISHTINË, MË 02 QERSHOR 2008, NR. 700</p>													
<p>Dipolma e dyte:</p>													
<h2 style="text-align: center;">JASMIR NAZIM MORINA</h2> <table border="0" style="width: 100%;"> <tr> <td style="width: 50%;"> <p>U lind më 29.08.1978 në Hodonoc.</p> <p>U regjistrua në vitin akademik 1997/1998.</p> <p>Studimet i mbaroi më 30 prill 2008 në:</p> <p style="text-align: center;">DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV</p> </td> <td style="width: 50%;"> <p>Born on 29.08.1978 in Hodonoc.</p> <p>Was enrolled in the academic year 1997/1998.</p> <p>Completed his/her studies on 30 April 2008 in:</p> <p style="text-align: center;">DEPARTMENT OF CONSTRUCTIONS</p> </td> </tr> <tr> <td colspan="2" style="text-align: center;">dhe mori titullin:</td> </tr> <tr> <td style="text-align: center;"><b>INXHINIER I DIPLOMUAR I NDËRTIMTARISË</b></td> <td style="text-align: center;"><b>DIPLOMA ENGINEER OF CIVIL ENGINEERING</b></td> </tr> <tr> <td colspan="2"> <p>t sipas <b>Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve: 6</b></p> </td> </tr> <tr> <td style="width: 50%;"> <p>Nota mesatare gjatë studimeve 6,74</p> <p>Nota e provimit të diplomës 9,00</p> <p>Prishtinë, 11 shkurt 2022</p> </td> <td style="width: 50%;"> <p>Level of qualification according to the <b>National Qualification Framework</b></p> <p>Average grade of studies 6,74</p> <p>Diploma examination grade 9,00</p> <p>Prishtina, 11 February 2022</p> </td> </tr> <tr> <td colspan="2" style="text-align: center;">Nr.1263</td> </tr> </table>		<p>U lind më 29.08.1978 në Hodonoc.</p> <p>U regjistrua në vitin akademik 1997/1998.</p> <p>Studimet i mbaroi më 30 prill 2008 në:</p> <p style="text-align: center;">DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV</p>	<p>Born on 29.08.1978 in Hodonoc.</p> <p>Was enrolled in the academic year 1997/1998.</p> <p>Completed his/her studies on 30 April 2008 in:</p> <p style="text-align: center;">DEPARTMENT OF CONSTRUCTIONS</p>	dhe mori titullin:		<b>INXHINIER I DIPLOMUAR I NDËRTIMTARISË</b>	<b>DIPLOMA ENGINEER OF CIVIL ENGINEERING</b>	<p>t sipas <b>Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve: 6</b></p>		<p>Nota mesatare gjatë studimeve 6,74</p> <p>Nota e provimit të diplomës 9,00</p> <p>Prishtinë, 11 shkurt 2022</p>	<p>Level of qualification according to the <b>National Qualification Framework</b></p> <p>Average grade of studies 6,74</p> <p>Diploma examination grade 9,00</p> <p>Prishtina, 11 February 2022</p>	Nr.1263	
<p>U lind më 29.08.1978 në Hodonoc.</p> <p>U regjistrua në vitin akademik 1997/1998.</p> <p>Studimet i mbaroi më 30 prill 2008 në:</p> <p style="text-align: center;">DEPARTAMENTI KONSTRUKTIV</p>	<p>Born on 29.08.1978 in Hodonoc.</p> <p>Was enrolled in the academic year 1997/1998.</p> <p>Completed his/her studies on 30 April 2008 in:</p> <p style="text-align: center;">DEPARTMENT OF CONSTRUCTIONS</p>												
dhe mori titullin:													
<b>INXHINIER I DIPLOMUAR I NDËRTIMTARISË</b>	<b>DIPLOMA ENGINEER OF CIVIL ENGINEERING</b>												
<p>t sipas <b>Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve: 6</b></p>													
<p>Nota mesatare gjatë studimeve 6,74</p> <p>Nota e provimit të diplomës 9,00</p> <p>Prishtinë, 11 shkurt 2022</p>	<p>Level of qualification according to the <b>National Qualification Framework</b></p> <p>Average grade of studies 6,74</p> <p>Diploma examination grade 9,00</p> <p>Prishtina, 11 February 2022</p>												
Nr.1263													
<p><b>Pretendimi nr.5</b></p>													

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, gjithashtu pretendon se i rekomanduari për kontratë ka ofruar çmime Jo/Normalisht të ulëta, në disa pozicione (pozicioni 54 dhe 80), duke mos i respektuar dispozitat e nenit 61 të LPP-se dhe të rregullores për çmime Jo/Normalisht të ulëta.

Eksperti shqyrtues, sqaron se nuk qëndron pretendimi i OE ankues, për mos respektim të dispozitave të nenit 61 të LPP-se, për faktin se sipas dispozitave të nenit 61 të LPP-se, vlerësimi i çmimit është e drejtë e autoritetit kontraktues. Vlen të përmendet fakti se vlera totale e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë është 69,940.50€, pra shumë afër vlerës së parashikuar të kontratës (vlera e parashikuar e kontratës: 70,000.00€).

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **"TRIANGLE" SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Renovimi i shkollave fillore -renovimi i rrjetit të ujësjes, kanalizimit në nyjat sanitare në IEAA"** me numër të prokurimit: **"616-23-10869-5-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **"TRIANGLE" SH.P.K.**

**Florije Rexhepi**

